

# PERMBLEDHJE JO TEKNIKE

## “THERTORE”


(Instalime për therjen e kafshëve)

## "STALLA"(si aktivitet ndihmes i thertoresh)

(Instalime për rritjen intensive të kafshëve)

VENDODHJA: Fshati Koder Lume, Nj.Ad.Shtiçen, Bashkia Kukes.

Investitor: HALLAÇI GROUP



Shtator, 2024

**Hyrje**

<b>1.</b>	
<b>2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.....</b>	<b>7</b>
<b>3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.....</b>	<b>10</b>
<b>4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS. ....</b>	<b>20</b>
<b>5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS. ....</b>	<b>24</b>
<b>6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE. ....</b>	<b>27</b>
<b>7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS .</b>	<b>27</b>
<b>8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.....</b>	<b>27</b>
<b>9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS. ....</b>	<b>28</b>
<b>10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR.....</b>	<b>28</b>

## 1.HYRJE

Ky raport paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, hartohet me kerkese te Z. Arjan Hallaçi (P.Fizik) per realizimin e aktivitetit “THERTORE” (INSTALIME PËR THERJEN E KAFSHËVE) DHE STALLA PER MBARSHTRIMIN E KAFSHEVE NE FUNKSION TE THERTORES. Ky aktivitet do te realizohet nga Subjekti “HALLAÇI GROUP” shpk duke iu referuar rregullores së urbanistikes, si dhe të konteksit urban, mjedisor e funksional të zonës. Qellimi i ketij subjekti eshte permbushja e kerkesave te tregut vendas per mish dhe nënproduktet e tij . Subjekti ka siguruar staf dhe pajisje profesionale per zhvillimin e ketij aktiviteti. Ky aktivitet do te nxise rritjen dhe cilesine e produkteve te blegtorise dhe produkteve e nenprodukteve te saj. Projekti i propozuar përbëhet nga ferma e kafsheve dhe thertore moderne të plotësuar me instalime të përpunimit të mishit. Projekti përbëhet nga një thertore moderne me një kapacitet për të therur dhe perpunuar produktin pothuajse per 20-30 deri ne 50-60 krerë gjedh në 1 ditë pune. Ndersa STALLA- Instalime për rritjen intensive të kafshëve, ka kapacitet maksimal 600 vende, kapacitet i cili nuk eshte arritur asnjehere deri me tani. Aktualisht kapaciteti i stalles ka arritur maksimalisht deri ne 300 krer gjedhi. Fabrika/thertorja do të ketë një nivel të lartë të higjienës e cila do të mundësojë prodhimin e produktit për t'u tregtuar ne te gjithë Shqiperine. Fillimisht eshte propozuar qe kafshët e gjalla do të blihen jashtë vendit si Bullgaria, Serbia, Kosova etj si dhe nga zona lokale dhe nga mbare territori shqiptar. Kapaciteti i projektuar eshte ne permasa te tilla, qe te nxise fermeret vendas te rrisin prodhimin dhe cilesine e tij, duke rritur keshtu ne menyre direkte dhe indirekte punesimin e shume individeve ose subjekteve te tjera private per tu angazhuar ne lidhje me kete lloj aktiviteti .

## 2. Vendodhja

Aktiviteti i cili do ti nënshtrohet procesit te VNM-se per “Instalime për therjen e kafshëve – Thertore HALLACI” dhe stalla per mbarshtrimin e kafsheve ne funksion te thertores, eshte ndërtuar ne zone rurale, e distancuar nga qendrat urbane 220, 340 dhe 540 ml large banesae me te aferta, konkretisht ne pronen me nr pasurie 564, zona kadastrale 3425, rreth 500 m ne verilindje te Fshatit Koder Lume, ne njesine Administrative Shtiçen. Siperfaqja ne te cilen ndodhet aktiviteti eshte territor administrativ i Bashkise Kukes, Qarku kukes. Infrastruktura rrugore e kesaj zone eshte e ndertuar dhe paraqitet ne gjendje pothuajse te mire.

Ortofoto

## Harta me Koordinatat e Aktivitetit

+

**Kordinatat Thertore "HALLACT"**

GAUSS KRUGER		KRGJSH		
	X	Y	X	Y
1	4453742.23	4659521.52	536373.126	4659331.095
2	4453741.06	4659541.14	536371.726	4659350.695
3	4453799.41	4659549.98	536429.966	4659360.215
4	4453808.72	4659531.95	536439.486	4659342.295

□

**Kordinatat Stalla "HALLACT"**

GAUSS KRUGER		KRGJSH		
	X	Y	X	Y
1	4453769.861	4659648.217	536399.264	4659458.097
2	4453784.908	4659689.764	536413.824	4659499.817
3	4453833.431	4659672.535	536462.544	4659483.157
4	4453804.538	4659596.427	536434.544	4659406.717



*Foto nga ambjentet e aktivitetit te thertores*



*Foto nga ambjentet e aktivitetit te stalles*



### 3. Pershkrimi i aktivitetit

Subjekti "HALLAÇI GROUP" shpk, nje subjekt i regjistruar me NIPT: M47505201V, me seli ne Kukes, Lagjja Nr.1, Rruga Pazarit, Zona Kadastrale Nr.2315, Nr.Pasurie 49/5, me administrator Z. Arjan Hallaçi, do te zhvilloj aktivitetin e tij ekonomik ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne fushen e tregtimit dhe perpunimit te mishi. Qellimi i firmes mbetet permbushja e kerkesave te cilesise dhe per kete kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilesise ne te gjitha hallkat e saj. Ky subjekt eshte i pajisur me Licence importi i gjësë se gjalle si dhe me licence per therjen e kafshëve te gjalla.

Ambjenti i thertoresh ka nje sipërfaqe prej 120 m<sup>2</sup>, Me konkretisht, ketu perfshihen: temperatura e mjedisit, sistemi i ventilimit, permbajtja e lageshtise, sasia e ndricimit, ngarkesa mikrobike e mjedisit, dhomat frigoriferike, sherbimet veterinare dhe kushtet shendetesore, si mjet parandalimi per te ruajtur mishin, nga infektimet apo semundje te ndryshme, qe mund te transmentohen si rezultat I neglizhences se masave te nevojshme.

#### LINJA E FUNKSIONIMIT TE THEROTRES

Z. Arjan Hallaçi, ben vete importin e gjedhit dhe te imtave nga vendet fqinje si Suedia, Serbia, Kosova etj Pra lënda e pare sigurohet kryesisht nga jashtë por edhe gjedh te vendit, fshatrat e Kukesit.

Procesi i punes fillon me pranimin e kafshëve (kryesisht gjedhit), ne nje ambient te përshtatshëm, e cila quhet stalla<sup>1</sup> e ruajtjes ose pritjes, ku mbahet kafsha maksimumi deri ne 72 ore përpara procesit të therjes. Ku paraprakisht ju matet temperatura nga veterineri.

Nese kalone 72 ore dhe kafshët ende nuk i jane nënshtruar procesit te therjes ato atëherë kalojnë per mbareshtim, pasi duhet ti nënshtrohen procesit te vaksinimit.

Pas pranimit, kafshët qëndrojnë në paratherje për tu ç'lodhur dhe i nënshtrohen procesit të urisë. Koha e qëndrimit në paratherje për bagëtitë e trasha është 24-72 orë në varësi të mundimit fizik, në varësi të moshës, peshës trupore dhe mundimit fizik që kanë kryer. Bagëtisë në periudhën e urisë i ndërpritet ushqimi dhe i jepet ujë i cili ndërpritet 2-3 orë para therjes. Pushimi dhe periudha e urisë bëhet për shumë arsye teknologjike: shmangien e mundimit fizik dhe ngacmimeve nervore që ndikojnë në procesin e çgjakësimit, zvogëlimin e përmbajtjes së ushqimit në aparatit tretës gjë që ndikon në uljen e ngarkesës mikrobiale, lehtëson proceset e mëtejshme të therjes si heqja e lëkurës, nxjerrja e organeve të brendshme etj. Gjatë trulllosjes nuk duhet që kafsha të humb funksionin e zemrës dhe organeve të frymëmarrjes pasi pengohet procesi i çgjakësimit duke bërë që të ulet cilësia e mishit. Trulllosja kryhet me këto mënyra: trulllosje mekanike konsiston në goditjen e bagëtive me mjete të forta në rajonin ospital të kafkës së kafshës. Mjeti më i përshtatshëm që përdoret është vareja, një çekiç i rëndë prej dy kilesh në formë konike dhe me gjatësi bishti rreth një meter.

#### *Therja*

Gjate procesit te therjes, kushtet e punes jane ne perputhje me parametrat e nevojshem teknike, teknologjike dhe rekomandimet e siguruara, ne bashkepunim te vazhdueshem me furnitoret, specialiste veterinare nga institucionet perkatese kombetare, nderkombetare, etj.

Futet kafsha ne boksen e therjes, me pas ngrahet me vinç dhe futet ne shine sipër dhe vijohet me procesin e heqjes se lëkurës.

Me pas nëpërmjet nje pajisje qe quhet PJEDAJ, behet heqja e te brendshmeve (mëlçi, zemer shpretke, veshka, dhjami, plenca, zorre)

#### *Kontrolli veterinar*

---

<sup>1</sup> Stalla ne kete raste eshte pjese e thertoresh  
Raporti Paraprak i VNM

Më pas vjen kontrolli veterinar, i cili konsiston në kontrollin e mishit i cili mund të jetë i prekur nga sëmundje të ndryshme si të mëlçisë, zemrës mushkërive dhe vetë mishit. Po ashtu kur mishi gjatë kontrollit del se është i prekur nga sëmundje veçohet, nderkohe ruhet ne ambientet e therteores ne kushte te përshtatshme (ne dhome frigoriferike ne temp -20° C), deri ne momentin qe veterineri merr vendimin per asgjësimin e tij.

Pas kontrollit veterinar, ne rastin kur klasifikohet per konsum, mishi vulozet nga mjeku veterinar dhe vlerësohet nga teknologu cilësia e mishit, lloji i tij sipas standardit në fuqi dhe jepet destinacioni i duhur.

Trupave të therur u bëhet edhe tualeti i cili është dy llojesh i njomë dhe i thatë.

- Tualeti i thatë konsiston në largimin e dhjamërave të barkut, pjesëve të gjakosura, gjëndrave të papërdorshme si ushqim, absceset, mbeturinat e mishit të diafragmës, mbetje të trakesë dhe të ezofagut etj.
- Tualeti i njomë bëhet gjithmonë mbrapa atij të thatë, ai kryhet me anë të dushit ku mishi lahet me uje të freskët dhe të ftohtë me qëllim që të largohen të gjitha papastërtitë dhe gjakrat në sipërfaqe. Tualeti i njomë gjithashtu ka për qëllim uljen e temperaturës së mishit të porsatherur. \*Kujdes I vecante tregohet mbas tualetit të njomë mbasi bëhet tharja me lecke të thatë ose me ventilim sepse lagështia që ngelet rrezikon prishjen e mishit.









*Pamje nga proceset e aktivitetit*

### ***Menaxhimi i te brendshmeve***

Persa i përket te brendshmeve si : mëlçi, zemer shpretke, veshka, dhjami, plenca, zorre, te gjitha shiten.

Plencat dhe zorrët pastrohen nga puntore, ku plenci shitet dhe zorrët perdoren per suxhuk nga vete subjekti Z. Arjan HALLACI, Person Fizik.

### **Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti**

Ndersa përmbajtja e plencit dhe zorrëve, ruhet ne ambjente te përshtatshme per tu përdorur si pleh organik per pleherimin e tokave bujqesore. Kete mbetje e terheqin banoret e zones pasi kan interes te larte per pleherimin e tokave bujqesore.

Ka shum fshatare dhe biznese ne rrethinat e Kuksit te cilat kane investuar ne kultivimin e tokave are, te cilët janë te interesuar per blerjen e plehut organik, me qellim plehërimin e tokave bujqesore.

Lekura e kafshës, lahet, kripet, me pas thahet, dhe me pas shitet tek personat e interesuar.

Këmbët pasi pastrohen, thahen dhe me pas shiten.

Vetem brirët, thundrat, te vetmet qe nuk riperdoren, keto mbetje terhiqen nga gjuetare ose persona te interesuar.

Persa i perket mbetjeve te lengshme te gjeneruara nga pastrimi i ambienteve te stalles, si dhe thertores, ato nepermjet kanaleve drenazhuese shkojne ne gropen dekantuese, para se ujrata te bashkohen me ato te rrjetit te kanalizimeve.

Procesi i Dekantimit eshte procesi i ndarjeve se termijave te ngurta si pasoje e forces gravitacionale. Procesi i Filtrimit. Eshte proces i cili realizon ndarjen e lengut nga trupi i ngurte, si pasoje e largimit te lengut ne nje mjedis poroz. Dhe puseta e dekantimit pastrohet ne menyre periodike me subjekte te licensuara per tërheqjen dhe trajtimin e mbetjeve teknologjike.


### Trajtimi i mishit

Persa i perket mishit ai ruhet ne dhome frigoriferike  $-5^{\circ}\text{C}$  ---  $+5^{\circ}\text{C}$ , deri ne 24 ore, dhe me pas nxirret ne treg per konsum.

Per tregtimin e mishit dhe nënprodukteve te tij, subjekti ka investuar edhe ne hapjen e nje dyqani mishi brenda ne qytetin e Kuksit, si dhe eshte lidhur me biznese ne te gjithë Shqiperine, te cilat janë te licensuara per tregtimin e mishit dhe nënprodukteve te tij.

Mishi shpërndahet nga thertorja per ne dyqanet e tregimit te mishit ne qytetin e Kuksit dhe gjithë Shqiperise, me makine frigoriferike, ku varet ne shina.

### Organigrama




### LËNDËT E PARA DHE NDIHMËSE

Aktiviteti nuk është një aktivitet i mirëfilltë prodhimi, prandaj nuk mund të flasim për lëndë të para për prodhim.

Si lende e pare ne kete aktivitet perdoret gjedhi.

Lende ndihmese Uji dhe energjia Elektrike.




- 1.Kafazi i therjes
- 2.Jesteku prites
- 3.Vaska e gjakut
- 4.Pedana per heqjen e lekuresh me rruj me presion vaji
- 5.Pedane e thjeshte qe ndihmon ne heqjen e lekures.
- 6.Pedana e heqjes se te brendeshme dhe e qarjes se karkase
- 7.Pedana e veterinerit
- 8.Dhoma e lekurave
- 9.Dhoma e te brendeshmeve
- 10.Banjo
- 11.Gardarobe
- 12.Dhome frigoriferike
- 13.Vaska e kulimit te gjaku(pileta) 11 cope
- 14.Linja e gaxhimit te mishit



[https://www.google.com/maps/@42.6401761,20.9161074,15z/data=!3m1!1e3!3m2!1sRr\\_25161074!3m1!1s18message?af6b011](https://www.google.com/maps/@42.6401761,20.9161074,15z/data=!3m1!1e3!3m2!1sRr_25161074!3m1!1s18message?af6b011)

*Planimetria e ambjentit te thertores*



*Planimetria e stalles*

### **Dyshemeja dhe muret**

Dyshemete jane te shtruara me pllaka me ngjyre te qarte per thertoren dhe me shtrese betoni per stallen. Jane te pastrueshme dhe te lashme, kane pendenca dhe mbyllje per largimin e ujrave qe rrjedhin nga larjet e shpeshta muret jane te veshura me pllaka dhe per pjesen qe mbetet jane te lyera me ngjyre te bardhe, jo absorbent, rezistent ndaj ujit, pa gropa ose te dala, pa te çara dhe pa asnje grope qe do te mund te ishte e pershtatshme per kolonite e parazitareve.

### **Tavani dhe dyert**

Ata jane te lyer me ngjyre te qarte, jane te suvatuara dhe jane te lashem. Siperfaqet e mbulimit jane te ndertuara duke patur parasysh rendesine e evitimit te depozitimit te mikrobeve, mykut, dhe per te reduktuar kondensimin. Portat jane te ilustruara, jo absorbente, jo te alteruara dhe te pastrueshme lehtesisht.

### **Dritaret dhe ventilimi**

Dritaret mbyllen ne menyre hermetike dhe ngjiten mire me murin. Ato jane ndertuar ne menyre te tille qe te evitojne akumulimin e papastertive. Kornizat e dritareve qe nuk nevojiten per ventilim jane te bllokuara. Zonat e punes jane te mirepershtatura me proceset e ndryshme te punes. Qarkullimi i ajrit sigurohet nepermjet ventilimit te mire i cili nuk lejon akumulimin e ngrohjes dhe avujve. Çdo dritare eshte e pajisur me rrjeta kundra insekteve dhe kalimit te tyre ne ambjentet e punes.

### **Ndriçimi**

Ne te gjitha ambjentet eshte siguruar nje ndriçim i pershtatshem. Llampat jane te pozicionuara ne menyre qe te jene te mbrojtura nga perplasjet apo thyerjet. Te gjitha pikat e ndriçimit jane te vendosura ne menyre te tille qe te ndriçojne ne menyre uniforme te gjithe ambjentin pa verbuar operatoret.

### **Tualetet dhe dhomat e zhveshjes**

Banjot kane sherbime higjenike per larjen/dezinfektimin e duarve te punonjesve, uje te ftohte, uje te ngrohte, sapun likuid, kartopeceta per te thare duart dhe kosh per mbledhjen e tyre pas perdorimit. Banjot nuk jane ne komunikim direkt me lokalet e punes dhe te stokimit dhe jane te mbajtura ne kushte higjenike te pranueshme per tere ditën dhe lahen e dezinfektohen çdo dite.

Lavamanet jane te pozicionuar ne pika, neper te cilat duhet te kalojne patjeter punonjesit e ndermarrjes ne dalje nga banjot, dhe perdorimi i tyre eshte i detyrueshem gjithmone kur hyhet ne repartin e punes.

Dhomat dhe dollapet e zhveshjes jane te mjaftueshem dhe jane me mure dhe me dysheme te sheshta, te suvatuara, te lashme dhe te padeptueshme nga uji. Eshte e parashikueshme, ne raport me numrin e perdoruesve te dollapeve te zhveshjes, nje numer i duhur i dollapeve per rrobat e punes dhe per rrobat civile. Eshte e ndaluar te vishen rrobat e punes jashte zones se punes apo te hyhet me rroba civile.

### **Ambienti i jashtem**

Ambienti jashte eshte i rrethuar. E gjithë siperfaqja qe rrethon strukturat e prodhimit eshte ne kushte te mira. E gjithë siperfaqja eshte e rregulluar per te minimizuar burimet e mundeshme te ndotjes nga ambienti i jashtem.

### **Skarcot e punes**

Skarcot e prodhimit (amballazhet apo mbeturinat e lendes se pare) akumulohen perkohesisht ne kontenitore brenda ambjenteve ne nje vend te percaktuar dhe largohen brenda nje kohe te shkurter duke u trajtuar si plehra.

# 1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR

## Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Ky Raport i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, është hartuar bazuar në legjislacionin mjedisor për VNM dhe ka për qëllim që të parashikojë, identifikojë, vleresojë dhe parandalojë ose minimizojë ndikimin në mjedis të projektit të propozuar.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Objektivat afatshkurter të VNM janë:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore të projektit të propozuar;
- Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrë të duhur dhe me efikasitet;
- Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
- Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të Disponueshme të teknologjive se propozuar për tu aplikuar.
- Identifikon masat e duhura për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit të propozuar;
- Mundëson informimin e vendim-marrësve, duke gjykuar në miratimin ose jo të projektit dhe kushteve që duhet të vendosen në aktin e miratimit.

Objektivat afatgjatë të VNM janë:

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimet e pakthyeshme të mjedisit;
- Ndikon në mbrojtjen e burimeve natyrore, peisazhet e natyrës dhe komponentet përberes të ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale-ekonomike të projektit/aktivitetit
- Ndihmon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit

## Përshkrimi i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin

Legjislacioni mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe demtimin e komponenteve të veçante dhe të rëndësishme të mjedisit nga faktorë të ndryshëm, njëzore dhe natyrore. Nder ligjet kryesore në lidhje me këtë projekt, mund të përmendim:

- ❖ Ligji nr.53/2020 për disa ndryshime në ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i cili përcakton kërkesën për vlerësimin e ndikimit në mjedis, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërkimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.
- ❖ Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, ndryshuar me ligjin nr. 12/2015, datë 26.2.2015, nr. 128/2020, datë 22.10.2020 (*i përditësuar*), i cili përcakton dhe specifikon kërkesat për vlerësimin e ndikimit në mjedis, projektet që i nënshtrohen, përgjegjësitë e palëve në proces;
- ❖ Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, ndryshuar me ligjin nr. 32/2013, datë 14.2.2013; nr. 156/2013, datë 10.10.2013; nr. 28/2022, datë 17.3.2022 (*I përditësuar*) i cili ka për qëllim të mbrojtë mjedisin dhe shëndetin e njeriut, si dhe të sigurojë administrimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet menaxhimit të integruar të tyre;

- ❖ Ligji nr. 41/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i cili kërkon ruajtjen dhe mbrojtjen e specieve biologjike dhe mbrojtjen e vlerave biologjike ku përfshihen edhe ekosistemet dhe habitatet;
- ❖ LIGJ Nr. 21/2024 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura” përmes të cilit synohet të sigurohet mbrojtje e veçantë për përbërës të rëndësishëm të rezervave natyrore, të biodiversitetit dhe të natyrës, në tërësi, nëpërmjet krijimit të zonave të mbrojtura.
- ❖ Ligji nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar dhe shfuqizuar me ligjin 57/2020 “Për Pyjet”,
- ❖ Ligji nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar, i cili ka për qëllim të përmirësojë shëndetin publik dhe të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet integritimit të çështjes së mbrojtjes së ajrit në politika të tjera, si dhe përcaktimit të kërkesave për pakësimin e shkarkimeve, monitorimin, vlerësimin, planet e cilësisë së ajrit, dhe për bashkëpunimin në nivel ndërkombëtar për këtë qëllim;
- ❖ Ligji nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” i ndryshuar, i cili përcakton kërkesat për mbrojtjen e mjedisit nga zhurma, mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma;
- ❖ Ligji Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i cili ndër të tjera ka si qëllim mbrojtjen e burimeve ujore nga ndotja.
- ❖ Ligji nr.9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisore të ujerave të ndotur”.
- ❖ Ligjin nr. 34/2013 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9115, datë 24.7.2003 “Për miratimin e ujerave të ndotura”, i ndryshuar
- ❖ VKM Nr. 575, date 24.06.2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”;
- ❖ Vendim nr. 229, date 23.04.2014 “Per Miratimin e Rregullave per Transferimin e Mbetjeve jo te Rrezikshme dhe Informacionit qe duhet te perfshihet ne dokumentin e transferimit”.
- ❖ Vendim nr. 371, date 11.06.2014 “Per Miratimin e Rregullave per Dorezimin e Mbetjeve te Rrezikshme dhe te dokumentin te Dorezimit te Tyre”.
- ❖ VKM Nr. 418, date 25.06.2014 “Per grumbullimin e diferencuar te mbetjeve ne burim”;
- ❖ VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.
- ❖ Vendim nr. 402 date 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” në të cilin kategorizohen tipet e mbetjeve dhe kriteret për klasifikimin e tyre;
- ❖ VKM Nr. 660, date 31.10.2018 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve te metaleve”
- ❖ VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjësive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar;
- ❖ VKM Nr. nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (vnm) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, Ndryshuar me vkm Nr. 828, datë 28.12.2023.

- ❖ VENDIM Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore. (ndryshuar me vendimin e KM-së nr. 268, datë 27.4.2023.
- ❖ VKM nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”, i cili përcakton monumentet natyrore në nivel qarku dhe rrethi që duhet të mbrohen nga veprimtaritë e ndryshme (duhet të evidentohet prania ose jo e tyre në zonën e projektit dhe masat që duhen marrë);
- ❖ VKM Nr. 803, datë 04.12.2003 “Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit”;
- ❖ VKM Nr. 248, date 24.04.2003 “Për miratimin e normave të përkohshme për emetimet në ajër dhe zbatimin e tyre”;
- ❖ VKM Nr. 352, date 29.4.2015 “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të ambientit dhe kërkesat për ndotës të lidhur me to”;
- ❖ Udhëzimi Ministror Nr. 6527, datë 24.12.2004 “Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe menyrat e kontrollit të tyre”;
- ❖ VKM Nr. 123, datë 17.2.2011 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis”;
- ❖ Udhëzim Nr. 1, datë 19.02.2018 Për përcaktimin e kërkesave minimale për hartimin e planeve të veprimit për zhurmat;
- ❖ Udhëzim nr. 8, datë 27.11.2007, i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe Ministrisë së Shëndetësisë “Mbi nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”, i cili përcakton nivelet e zhurmave në mjedise të caktuara, të cilat duhet të mbahen parasysh gjatë zbatimit të projektit për segmentin e rrugës që kalon nëpër qendra të banuara ose pranë tyre;
- ❖ VKM nr. 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”, i cili synon të parandalojë, të zvogëlojë dhe të shmangë ndotjen e mjediseve ujore pritëse nga substancat e rrezikshme, që shkarkohen në to përmes ujërave të ndotura, duke përcaktuar vlerat kufi për përbërësit e lejuar;
- ❖ VKM nr. 643, datë 14.09.2011 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare Sektoriale të Shërbimit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve”
- ❖ VKM nr.1304 , datë 11.12.2009 “Për Miratimin e Modelit të Rregullores për Furnizimin me Ujë dhe për Kanalizimet në Zonën e Shërbimit të Ujësjellës Kanalizimeve sha”
- ❖ Rregullore nr. 1 datë 15.03.2006 “Për parandalimin e ndikimeve negative në shëndet e në mjedis të veprimtarive ndërtimore”, e cila përcakton masat që duhet të zbatohen nga personi fizik ose juridik që ushtron veprimtari ndërtuese për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndikimet negative të saj.
- ❖ Urdhërit të Kryeministrit Nr. 153 Prot, datë: 25.11.2019 “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line nga data: 01.01.2020“;
- ❖ LIGJ Nr. 120/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar si dhe aktet e tjera ligjore në fuqi për supervizimin e punimeve të ndërtimit;
- ❖ UDHËZIM Nr.3, datë 15.2.2001 PËR MBIKËQYRJEN DHE KOLAUDIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT I ndryshuar me: Udhëzim i KM Nr.4, datë 17.5.2001;Udhëzim i KM Nr.7, datë 21.11.2001; Udhëzim i KM Nr.1, datë 22.2.2005; Udhëzim i KM Nr.1, datë 16.06.2011



- ❖ Ligji nr. 119/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.107/2014, datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala për zbatim të tij;
- ❖ VENDIM Nr. 408, datë 13.5.2015 Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit
- ❖ Ligjin nr.52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit”.
- ❖ Ligji nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”
- ❖ VKM-së nr. 488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, si dhe
- ❖ VKM-së nr. 9, datë 9.1.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”
- ❖ LIGJ Nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”
- ❖ VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”
- ❖ VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”
- ❖ Ligji nr.9863, datë 28. 01. 2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar .
- ❖ Ligji nr.10081, datë 23.02.2009 “Për Liçensat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”.
- ❖ VKM nr.583, datë 26.05.2009 “Për Liçensat dhe Lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçensimit
- ❖ Rregullorja nr.2. date 1.11.2002 “Per mbrojtjen e kafsheve gjate therjes si dhe kerkesat e aplikueshme per thertoret”
- ❖ Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nr. 20, datë 25.11.2010 “Për zbatimin e programeve paraprake, të praktikave të mira të higjienës, praktikave të mira të prodhimit dhe procedurat e bazuara në HACCP në stabilimentet ushqimore” (bazuar në Rregulloren 853/2004/KE dhe 854/2004/KE).
- ❖ Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nr. 21, datë 25.11.2010 “Mbi kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollet zyrtare për produktet me origjinë shtazore”(bazuar në Rregulloren 853/2004/KE dhe 854/2004/KE).
- ❖ Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nr. 22, datë 25.11.2010 “Për kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të higjienës për stabilimentet e ushqimit dhe operatorët e biznesit ushqimor” (bazuar në Rregulloren 852/2004/KE).
- ❖ Udhëzim i Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nr. 23, datë 25.11.2010 “Për kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit, duke përfshirë produktet e mishit, mishin e grirë dhe mishin e ndarë në menyrë mekanike” (bazuar në Rregulloren 853/2004/KE dhe 854/2004/KE).

***Shenim:***

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, hartohet për aktivitetin “Thertore -Hallaci” Fshati, Koder Lume, Nj.Ad Shtiqen, Bashkia Kukes, Qarku Kukes. Ky raport paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, do të paraqitet pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, për t'u nënshtruar procedurës paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, sipas kërkesave të Ligjit

Nr. 10440, date 07.07.2011 Per VNM, Shtojca II dhe VKM Nr. 686, date 29.07.2015 Per VNM, referuar përgjigjes se AKM-se ne shkresën me Nr.1919/3 Prot, date 05.03.2024 "Ne baze te Shtojcave I dhe II, te Ligjit nr. 10 440, date 07.07.2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis", te ndryshuar, projekti "Thertore, me kapacitet prodhues te karkasave i barabarte me 50/ton ne dite ose me pak", me vendndodhje: Koder Lume, rruga "Koder Lume", Kukes, duhet t'i nenshtrohet Procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis.

## **2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.**

### **Mjedisi Biologjik**

Kuksi njihet per nje diversitet te larte te ekosistemeve. Brenda territorit te tij ka ekosisteme liqenore, lumore, shkurre me gjelberim te perhershem dhe gjethegjere, pyje dushku dhe ahu, pyje me pisha, kullota dhe livadhe alpine e subalpine, si dhe ekosisteme te larta malore.

#### **Flora**

Rrethi i Kukësit është mjaft i pasur në bimësi si në lloje ashtu edhe në shtrirje. Në qarkun e Kukësit takohen territore me mikroklimë të ashpër malore, ku rriten dhe zhvillohen pyje fletorë dhe halorë. Si rrjedhojë, mbulesa bimore përbëhet nga dy grupe kryesore, që dallohen mirë nga njëra-tjetra. Bimësia me mbizotërim të elementeve floristik që zhvillohen në zonat me lartësi si (Koritniku, Gjalica, Kolesjani, Zepa, Alpet, Pashtriku etj.) dhe bimësia e tipit mesdhetar, e cila me ndërprerje depërton nëpërmjet luginave lumore të Drinit të bashkuar deri në qytetin e Kukësit. Bimësia është e përhapur në kate, por kufiri i tyre është i vështirë të dallohet. Për shkak të karakterit malor të territorit bimësia shkallëzohet vertikalisht në breza të ndryshëm. E fillon me brezin e shkurreve, vazhdon me atë të dushkut, ahut dhe përfundon me kullotat alpine. Për arsye të ndikimit të klimës lokale dhe formave të ndryshme të relievit në të njëjtin kat vërehen përzierje bimësh.

Brezi i shkurreve përfshin një sipërfaqe prej 3160 ha. Në Kukës dhe disa zona të ulta të Tropojës gjenden shkurre si bushi, frashëri i bardhë, çermëdella, shkoza e zezë, lajthitë etj.

Brezi i dushkut shtrihet në lartësitë 800–1200 m mbi nivelin e detit ku bëjnë pjesë lloje të ndryshme panjash, frashëri i bardhë të cilat takohen në kurrizet e shpatet e kodrave, në rrëzën e maleve etj.

Brezi i ahut shtrihet në lartësinë 1500–1800 m mbi nivelin e detit kryesisht në shpatet lindore dhe veriore të maleve. Ata formojnë masive pyjore në malin e Gjalicës, Kallabakut, Kolesianit etj. Brenda pyjeve të ahut rriten edhe lloje të tjera drurësh gjethegjerë si shkoza e bardhë, panja e malit, panja si rrap, kurse nga drurët halorë takohet bredhi i bardhë, pisha e zezë dhe arneni. Brezi i ahut nuk formon një brez të vetëm e të pandërprerë, por është i ndërprerë nga halorët në lartësinë 1600–800 m.

Brezi i kullotave alpine shtrihet mbi lartësinë 2000–2400 m. Ato zënë një sipërfaqe së bashku me livadhet prej 12410 ha. Kullotat shtrihen kryesisht në malin e Koritnikut, Gjalicës, Lumës, Shishtavecit, Kollovozit, Kolesianit dhe Pashtrikut.

Territori ku zhvillon aktivitetin Z. Arjan Hallaçi (P.Fizik) dallohen shoqerime bimore, formacione, e grupime te thjeshta. Ne zonen prane gjenden shkurre si bushi, frashëri i bardhë, çermëdella, shkoza e zezë, lajthitë etj.



*Foto te mbulesës bimore te zonës pranë*

## Fauna

Bota shtazore e qarkut të Kukësit me gjithë dëmtimet, ka përfaqësuesit e vet në të gjitha rrethet. Nga gjitarët grabitqarë (karnivore) që takohen në këto rrethe janë: ujku, dhelpra, rrëqebulli, macja e egër, kunadhja, zardafi, qelbësi, ariu, vjedulla etj. Nga gjitarët jograditqarë janë: baldosa, derri i egër, lepuri, ketri, kaprolli, urithi, iriqi dhe më rrallë dhia e egër.


Ndër shpendët grabitqarë janë: sorrat, laraskat, kukumjaçka, bufi, hutini, harabeli, gala, skifteri, fajkoi dhe shqiponja e malit. Midis shpendëve jograditqarë janë: pëllumbi i egër, turtulli, gjeli i egër, shkurta, shapka dhe thëllëza e malit.

Nga kafshët e ujit takohet: lundra (vidra) e cila jeton si në tokë ashtu edhe në ujë, rosa e egër, lloje të ndryshme peshqish, bajza, pulbardha dhe rrallë lejlekë.

## Zonat e Mbrojtura

Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN. Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive.

Krijimi i Zonave të Mbrojtura ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asete të rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente të Natyrës pyjet me vlerë shkencore, biologjike, historike dhe didaktike. Zona ne vlerësim nuk vlerësohet si zone me status te veçante nga MM. Sic shihet edhe ne hartën e mëposhteme, zona ne vlerësim nuk shtrihet brenda zones se mbrojtur dhe per me teper ndodhet e distancuar nga to ne nje distance prej 1.8 Km ne vije lineare.



Harta e pronës ne lidhje me ZM

Emri i Zonës së Mbrojtur	Vendndodhja	Kategoria	Sipërfaqe (ha)
Lumi i Gashit	Qarku Kukes, Bashkia Tropoje	IUCN I: Rezerve rreptesisht natyrore/rezerve shkencore	3.000
Lugina e lumit të Valbones	Qarku Kukes, Bashkia Tropoje	IUCN II: Park kombetar	8.000
Tej Drini Bardhe	Qarku Kukes, Bashkia Has	IUCN IV: Rezerve natyrore e mbrojtur/Park natyror	30
Nikaj Mertur	Qarku Kukes, Bashkia Tropoje	IUCN IV/1: Park natyror rajonal	17.505
Korab-Korritnik	Qarku Kukes dhe Diber, Bashkite Kukes dhe Diber	IUCN IV: Park natyror	34.886

### 3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Mjedisi Ujor është pasuri për territorin e bashkise Kukës. Në të gjenden burime ujore sipërfaqesore dhe nentokesore, të cilat përdoren nga komuniteti për të përdorur apo edhe për nevojat e tjera. Ujra që mundësohen nga akuifere të tipeve të ndryshme.

Kuksi është i dyti me rezervat më të mëdha ujore në vend pas Shkodrës. Liqeni i Kukësit është një nga liqenet artificiale më të mëdha në vend i krijuar me 1978 nga lumenjtë Drini i Bardhë, Drini i Zi, dhe lumi i Lumes, me një gjatësi 72 km dhe një sipërfaqe prej 8169 ha, ky liqen përbehet nga 40 gjire.

Drini është një nga lumenjtë kryesorë të qytetit të Kukësit por edhe të vendit, i cili kalon nepermjet pjesës juglindore të Gadishullit Ballkanik dhe nepermjet territoreve të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë, i gjatë 355 km, i cili përbëhet nga 3 pjesë: Drini, Drini i Bardhë dhe Drini i Zi. Drini kalon në zonën e veriperëndimit të liqenit të Fierzës dhe përfundon në liqenin e Shkodrës, ku bashkon ujrat e tij me ato të lumit Buna dhe derdhet në detin Adriatik.

Sistemi i ujit që përfshin liqene dhe lumenj është përdorur kryesisht për energji elektrike, bujqësi dhe furnizim me ujë. Problemi kryesor i të cilit është lidhur me ndotjen si pasojë e shkarkimit të ujit të patrajtuar. Monitorimi i analizave të kryera në vitet e fundit tregojnë një ndikim të rëndësishëm në cilësinë e ujit të lumenjve dhe liqeneve.

Në mënyrë të vecantë ujrat më të ndotura janë në afërsi të burimeve të ndotjes, si zonat industriale ekzistuese, komplekseve të dikurshme industriale dhe vendeve të minierave dhe të përpunimit mineral.

Në zonën e zbatimit të këtij projekti nuk ka burime ujore të identifikuara. Objekti ndodhet i distancuar nga burimet ujore të rëndësishme si Lumenjtë kryesorë, Liqene, apo Rezervuar.

Distancat e trupave ujore më të afërt nga kufiri i pronës që zhvillohet aktiviteti është liqeni i Fierzës ku distanca më e afërt është 630 m, si dhe një përrua i cili rrjedh në një distancë prej 220 m në vijë lineare larg sipërfaqes së aktivitetit.



Distancat nga trupat ujore

Liqeni artificial i Fierzës është krijuar në shtratin e lumit Drin në vitin 1978, në funksion të hidrocentralit të Fierzës. Ky është një liqen oligotrof dhe ka një bosht gjatësor prej 70 kilometër dhe me një sipërfaqe maksimale prej 7 mijë hektarësh, ku 5 mijë hektarë merren në konsideratë për qëllimin e rritjes dhe kultivimit të peshkut. Ky liqen ka lartësi 167 metra, sipërfaqe të pasqyrës së ujërave prej 72,5 km<sup>2</sup>, thellësinë më të madhe prej 128 metra dhe një vëllim prej 2,7 miliardë metër kub ujë. Sipërfaqja e përgjithshme e pellgut ujëmbledhës është 11.829 km<sup>2</sup>.

Kapaciteti maksimal ujëmbajtës i Liqenit të Fierzës, arrin rreth 3,2 miliardë metër kub ujë, ndërkohë që kapaciteti minimal, i cili mund të shkaktojë edhe situatat më kritike të prodhimit të energjisë elektrike, është rreth 1,2 miliardë metër kub ujë.

Liqeni shërben edhe si nyje lidhëse mes banorëve të rretheve Kukës, Tropojë, Has dhe Pukë. Gjithashtu, ky hidrocentral shërben si rregullator i furnizimit me ujë për dy hidrocentralet e ngritura në kaskadën e Drinit, atë të Vaut të Dejës dhe Komanit.

#### Shtresa vjetore e reshjeve

Në pellgun e Drinit të Zi dhe Drinit të Bardhë shtresa vjetore e reshjeve është përcaktuar në bazë të të dhënave të vendmatjeve gjatë periudhës 35 vjeçare (1951- 1985). Ndryshimet morfohidrografike që vihen re në rrjedhjen e Drinit të bashkuar, bëjnë të mundur të dallohen tre sektorë: ai I sipërm, I mesëm dhe I poshtëm. Sektori I sipërm përbëhet nga rrjedhjet e Drinit të Zi dhe të Drinit të Bardhë derisa derdhen në liqenin artificial të Fierzës. Drini Zi (149 km I gjatë) buron nga liqeni I Ohrit (694 m mbi nivelin e detit) dhe derdhet në Liqenin e Fierzës. Drini i Bardhë (134 km I gjatë) buron nga malsia e Zhlebit në rrëzë të majës Ruseli (Bjeshkët e Namuna të Kosovës) dhe derdhet po ashtu në Liqenin e Fierzës. Vargmalet që shtrihen në dy shpatet, qoftë të Drinit të Zi dhe të Bardhë, marrin sasira të mëdha reshjesh, mbi 2000 mm, të cilat ushqejnë dy lumenjtë me reshje të bollshme që kanë ndikim në rrjedhjen ujore dhe shpërndarjen e tyre. Shtresa e borës është një burim tjetër ushqimi me ujë për Drinin e Zi dhe të Bardhë.

#### Shpërndarja vjetore e rrjedhës

Në shpërndarjen vjetore të rrjedhjes ujore pasqyrohet ndikimi I faktorëve të ndryshëm fiziko-gjeografikë, sidomos ndryshimi gjatë vitit, I reshjeve atmosferike dhe I temperaturës së ajrit, si pasojë edhe avullimit. Lumenjtë Drini i Zi dhe Drini I Bardhë dallohen për tipin mesdhetar të shpërndarjes së rrjedhjes ujore brenda vitit. Të dy lumenjtë sipas vendmatjes në stacionin e Kukësit, derdhen në Drinin e bashkuar përkatësisht 38.6m<sup>3</sup>/sek dhe 19.5m<sup>3</sup>/sek. Prurja mesatare e Drinit të Zi është 118m<sup>3</sup>/sek dhe Drinit të Bardhë 68.8m<sup>3</sup>/sek. Në lumin Drin janë ndërtuar 3 hidrocentrale të mëdha (Vau I Dejës, Komani dhe Fierza) me fuqitë përgjithshme të instaluar prej 1 350.000 kw. Rëndësi të veçantë për Qarkun e Kukësit ka hidrocentrali I Fierzës, ndërtuar në afërsi të fshatit Fierzë I cili filloi të ndertohet në nëntor të viti 1971 dhe u vu në shfrytëzim më 1978. Diga ka krijuar një rezervuar liqeni 2.7 miliard m<sup>3</sup> ujë.

#### Burimet nëntokësore

Rethi i Kukësit ka potencial të konsiderueshëm të ujërave nëntokësore sidomos të burimeve karstike. Burimet dalin në rrëzë të maleve, brenda kanioneve apo në kontaktin e shkëmbinjve të përshkueshëm me ata të papërshkueshëm në lartësitë mbi 600–800 m deri në 1000 m. Burimet përbëjnë një pasuri të madhe në rrethin e Kukësit. Ata janë furnizuesit kryesorë të qendrave të banuara rurale me ujë të pijshëm. Qyteti i Kukësit që merr ujë për 24 orë e siguron atë nga burimet masive të Bjeshkëve të Kolosjanit.

#### Mjedisi

Kukësi kufizohet në veri me Bashkinë Krumë, në perëndim me bashkitë Mirditë dhe Fushë-Arrëz, në jug me Bashkinë Dibër dhe në lindje me Republikën e Kosovës dhe me atë të Maqedonisë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Kukësit.

Sipas Censurit të vitit 2011, popullsia është 47,985 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki ka 59,393 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 933.86 km<sup>2</sup> me një densitet prej 63.59 banorë/km<sup>2</sup> sipas Regjistrimit Civil dhe 51.38 banorë/km<sup>2</sup> sipas Censurit 2011.

Kjo bashki përbëhet nga 15 njësi administrative, të cilat janë: Kukësi, Malzi, Bicaj, Ujmisht, Tërthore, Shtiqën, Zapod, Shishtavec, Topojan, Bushtricë, Grykë-Çajë, Kalis, Surroj, Arrën dhe Kolsh. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit Kukës dhe pjesë e po këtij qaraku. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 87 fshatra. Për të parë listën e plotë të qyteteve dhe fshatrave të kësaj bashkie, klikoni këtu

Kukësi ishte një qendër industriale gjatë regjimit komunist në Shqipëri. Deri në vitet '90, Kukësi kishte industri të nxjerrjes dhe shkrirjes së bakrit (teknologji sovjetike e viteve '60), nxjerrjes dhe koncentrimin të mineralit të kromit, nxjerrjes së mineralit të kuarcit, prodhimit të materialeve të ndërtimit (materiale inerte, parafabrikate etj).

Ai njihet si një vend me traditë në rritjen dhe mbarështimin e deleve. Cilësia e mishit dhe e leshit të deleve lumjane ishte e njohur në të gjithë Ballkanin. Kukësi ishte gjithashtu një qendër e njohur e transportit. Krahas llojeve të tjera të transportit, aty ishte i zhvilluar dhe transporti ujor përmes liqenit artificial të Fierzës, i cili bënte të mundur lëvizjen e mallrave dhe të udhëtarëve si dhe zhvillimin e turizmit. Që prej vitit 2000, transporti përmes Liqenit të Fierzës ka pushuar së ekzistuari.

Një pjesë e konsiderueshme e banorëve të qytetit dhe të fshatrave punonin në zonën nxjerrëse dhe përpunuese të kromit në Kalimash si dhe në minierën e nxjerrjes së bakrit në Gjegjan. Transformimet e domosdoshme ekonomike drejt tregut të lirë pas viteve '90 bënë që pjesa më e madhe e industrisë së lartpërmendur të falimentojë tërësisht, sepse ajo industri ishte ngritur për të funksionuar në kushtet e një ekonomie të centralizuar.

#### Pozita gjeografike

Kukësi shtrihet në pjesën verilindore të Krahinës Malore Qëndrore në pellgun me të njëjtin emër, vendosur në gjërësinë gjeografike veriore ndërmjet 41°17'29 dhe 42°05'09 dhe në gjatësinë gjeografike lindorë nga 19°23'30 dhe në 20°23'23.

Kukësi ka formën e një shumkëndëshi me gjatësi, veri-jug 26 km dhe gjerësi 35 km, sipërfaqja 956 km<sup>2</sup>, ndërsa vija kufitare është 156 km.

Nga veriu kufizohet me rrethin e Hasit me vijën kufitare 34 km, nga lindja me vijën kufitare shtetërore 41 km, nga jugu me rrethin e Peshkopisë 40 km dhe nga perëndimi me rrethin e Rrëshenit 21 km dhe rrethin e Pukës 20 km

#### Ndërtimi gjeologjik

Gjeologjikisht rrethi i Kukësit përfshihet në kontaktin e përplasjes së tre zonave tektonike, të Mirditës, Alpeve dhe zonës së Gashit, që në reliev përfaqësohen me vargje malore në trajtë horsti: vargu qëndror dhe lindor. Këto vargje ndahen nga njësi grabënore Kashnjet-Burrel dhe Kukës-Dibër.

Ndërtohet nga shkëmbinj sedimentarë, magmatikë dhe metamorfikë të vendosur e të mbivendosur nga tektonika, veçanërisht ajo vertikale e diferencës e Tërciarit të vonshëm. Përhapja e tyre është kryesisht ndërmjet Gjinajt dhe Gjegjanit, ndërsa depozitimet më të reja në moshë mbulojnë fundin e pellgut dhe luginat kryesore lumore (Drini i Bardhë dhe Drini i Zi).

Gëlqerorët kanë shtrirje të konsiderueshme, prandaj i japin tonin kryesor morfologjisë së relievit që ndërtojnë vargun malor lindor (Koritnik-Gjallicë-Lumë). Në këtë të fundit janë të zhvilluara shpellat, pusët dhe format e tjera karstike mbi e nëntokësore me interes të veçantë dhe në fushën e turizmit. Sizmika e zonës është relativisht aktive.

Fuqia sizmike e hasur ka arritur në madhësinë 508 ballë dhe intensitet 9 ballë. Rol të madh në amortizimin e valëve sizmike luan bazamenti shkëmbor gëlqeror që kap sipërfaqen më të madhe të rrethi

## Relievi

Gjalica është mali më i lartë i rrethit Kukës, 2489m mbi nivelin e detit. Bën pjesë në vargun malor të Korabit (vargmal në skajin lindor të Shqipërisë, midis rrethit të Kukësit e atij të Dibrës) dhe shtrihet në skajin verilindor të këtij vargu, midis pellgut të Kukësit në veri-perëndim dhe pllajës së Shishtavecit në jug-lindje. Në veri-lindje Gryka e Vanave e ndan nga mali i Koritnikut, kurse kanioni i Bicajt në jug-perëndim e ndan nga mali i Kolesjanit.

Pjesa kulmore formon një kreshtë të mprehtë, që bie pingul mbi grykën e Vanave, kurse shpatet janë mjaft të pjerrëta duke formuar rrëpira të dukshme tektonike në gëlqerorët e pjesës së poshtme të tyre. Ka formë vezake (11 x 5 km) me drejtim veri-lindor dhe jug-perëndimor, me shpate shumë të pjerrëta që bien thikë mbi lumin Lumë, pëllgun e Kukësit dhe pllajën e Shishtavecit.

Nga ana perëndimore, nga të gjitha pikat, me një vështrim mund të perceptohet e gjithë përmasa e Gjalicës që ngrihet si një piramidë gjigande mbi Rrafshën e Lumës, skematikisht në formën e një trekëndëshi të stërmadh gati dybrinjëshëm me një bazë prej afro 11 km (Gryka e Vanave-Kanioni i Bicajve) dhe lartësi mbi 2100m.

Në rreth 90% të perimetrit të Gjalicës dallohet lartësia prej më se 2000 metër dhe sipërfaqet e shpateve nga rreza deri në majë, dukuri që nuk hasen te asnjë mal i vargmalit të Korabit, Alpeve të Shqipërisë apo gjetkë

## Klima

Rrethi i Kukësit ndodhet kryesisht në zonën e klimës mesdhetare paramalore dhe malore, nën zona veriore dhe lindore, zonë mjaft e përshtatshme për zhvillimin ekonomik-social, turistik, sidomos dhe në zhvillimin e sporteve dimërore, ngjitjeve alpinistike, rrëshqitjeve në borë. Klima është mesdhetare malore, gjë që pasqyrohet qartë në temperaturat, karakterin dhe shpërndarjen e reshjeve, sasinë dhe formën e rënies së tyre dhe zgjatjen e shtresës së barës, erërat dhe rrezatimin diellor si dhe elementët e tjerë klimatikë.

Ajo është një prej faktorëve ekologjikë që ka ndikim të drejtpërdrejtë në ekuilibrin, drejtimin dhe organizimin e punëve në bujqësi, blegtori dhe bimësi duke influencuar në lidhjen midis bimësisë dhe kushteve edafike.

## Diellzimi

Shpërndarja e rrezatimit të përgjithshëm në këtë rreth varet nga kushtet e motit dhe vranësira.

Në Kukës sasia e përgjithshme e rrezatimit diellor në vit është 1422.28 kwh/m<sup>2</sup>.

Maksimumi i rrezatimit të përgjithshëm është në muajin korrik me vlera 189.20 kwh/m<sup>2</sup>. Zgjatja faktike e diellzimit për rrethin e Kukësit është nga 61 orë në janar deri në 312 orë në muajin korrik. Vlerat më të vogla të sasisë së orëve me diell, për të gjithë territorin e rrethit, vërehen në muajin dhjetor, që përkon me zgjatjen më të vogël astronomike të ditës.

## Temperatura e ajrit

Sipas vrojtimeve të fundit del se temperatura mesatare vjetore është 11.8 °C dhe amplituda vjetore 21.5 °C, që ka dhe temperaturë mesatare më të ulët, kjo për shkak të lartësisë dhe pozicionit.

Maksimumi absolut i temperaturës në Kukës është shënuar në gusht 1957 që ka arritur vlerën 39.5 °C, kurse minimumi absolut është shënuar në 27 janar 1963 që ka arritur vlerat 21 °C. Periudha e vegetacionit për bimët në këtë rreth është plotësisht e mundshme për rritjen normale të drithërave të bukës dhe të pemëve frutore, pasi dita zgjat 9-15 orë.

Mesatarja faktike e temperaturës së tokës në Kukës është 13.8 °C, duke u luhatur nga 5 °C në janar deri në 22.7 °C në korrik.



## **Lagështia e ajrit**

Lagështia e ajrit është një tjetër element i rëndësishëm i klimës në këtë rreth.

Shperndarja e tensionit të avujve të ujit, në rrethin e Kukësit, varet nga temperatura e ajrit. Në Kukës mesatarja vjetore e tensionit të avujve të ujit arrin 908 mb. Në janar është 5.3 mb dhe në korrik 14.7 mb.

Amplituda mesatare vjetore arrin vlera të larta (20-30%), kurse në ultesirën bregdetare, kjo amplitudë lëkundet ndërmjet 13-20%. Një rëndësi të vecantë merr numri mesatar i ditëve me lagështi më të vogël ose të barabartë me 30% dhe 50% që për Kukësin janë 11.3 ditë dhe 17.5 ditë. Mesatarja vjetore e deficitit të lagështirës për Kukësin është 6.9 mb. Në janar është 1.6 mb dhe në gusht është 14.4 mb.[19]

## **Vranësira**

Veprimtaria ciklonike është më intensive në stinën e dimrit, sidomos në muajin dhjetor ku vranësirat arrijnë deri në 7.8 ballë që përbën dhe treguesin më të lartë dhe për gjithë vendin.

Për rrjedhojë, rrethi i Kukësit dallohet për ditët e pakëta të kthjellëta, mesatarisht 76.6 ditë në vit, kur në muajin janar ka vetëm 3.2 ditë dhe në gusht 14.4 ditë.

Numri mesatar i ditëve të vranëta në Kukës arrin 131.1 ditë, nga 18.5 ditë në janar dhe 3.2 ditë në korrik.

## **Reshjet atmosferike**

Reshjet atmosferike në rrethin e Kukësit janë të përqëndruara më tepër në shpatet perëndimore dhe jugperëndimore të vargmaleve dhe më pak në shpatet lindore.

Sasia mesatare shumëvjeçare e reshjeve në Kukës arrin shumën 946 mm, ku mbi 70% e tyre është e përqëndruar në muajt e vjeshtës dhe të dimrit (570 mm) dhe vetëm 15% gjatë stinës së verës (143 mm).

Në stinën e dimrit një pjesë e reshjeve bie në formën e borës që fillon nga muaji tetor deri në prill. Trashësia e borës arrin nga 80 cm deri në 1 m. Numri i ditëve me borë arrin mesatarisht në 24 ditë, më shumë ajo zgjat në janar deri në 10.4 ditë. Breshëri në Kukës është një fenomen i rrallë dhe zgjat 1-2 ditë vetëm për pak minuta (3-5 min).

## **Era**

Erërat veriore së bashku me ato verilindore, në dimër përbëjnë 23.6% të të gjitha rasteve, në pranverë 23.3 %, në verë 22.2% dhe në vjeshtë 19.4%. Erërat lindore dhe perëndimore, të marra së bashku, në dimër dhe në vjeshtë kanë një rastisje 0.8-01.9%, kurse në verë dhe pranverë 2.2-2.8%.

Kështu, Lugina e Drinit të Bardhë luan rolin e një korridori me rëndësi për hyrjen e masave ajrore të ftohta kontinentale në territorin e Shqipërisë. Shpejtësitë e mëdha të erës në orën 14<sup>oo</sup> janë rezultat i konveksionit të fuqishëm që vërehet në orën e mesditës duke arritur shpejtësinë 6.6 m/sek.

Shpejtësia maksimale e erës në Kukës ka arritur vlerën 59.5m/sek , me rastisje një herë në 2.5,10,20 dhe 50 vjet.

## **Tokat**

Tokat e rrethit të Kukësit janë formuar mbi depozitimet e kuaternarit, shistet argjilore, konglomeratet e molasat, gelqerorët dhe ultrabazikët. Në përgjithësi, tokat dallohen për përmbajtje të ulët të lëndëve ushqimore. Kjo lidhet me kushtet e formimit të tyre, me praninë e fenomenit të erozionit dhe kushteve natyrore gjeofitoklimatike të rrethit. Sipërfaqja e tokës së punueshme zë 16% të rrethit. Për shkak të shtrirjes së territorit të qarkut dhe përbërjes gjeologjike të shkëmbit amnor gjenden të 4 tipet kryesore të tokës për sa i përket shtrirjes vertikale si: toka të hinjta kafe, të kafejta, të murrme pyjore dhe livadhore malore. Tokat e kafenjta malore

gjenden në lartësitë 1000m mbi nivelin e detit të përhapura në Shishtavec, Lusnë, Kollovoz, Morinë, Borje etj Tokat e hijta kafë shtrihen thuajse në pjesën kodrinore 6000-8000m dhe pikërisht përreth pellgut të Kukësit dhe në shtretërit e luginës së Drinit të Zi dhe Drinit të Bardhë. Tokat e murrme pyjore gjenden në zonat e larta malore mbi 1000 m. Tokat livadhore malore shtrihen në sipërfaqe të shkëputura në të dy anët e lumenjve Drini i Zi dhe Drini i Bardhë si dhe degët e tyre. Përgjithësisht, të gjitha llojet e tokave dallohen për potencial biologjik të mirë në drejtim të bimësisë së kultivuar, të frutikulturës dhe nga ana tjetër për kapacitete mbrojtëse kullimore të konsiderueshme në lloje të bimësisë me interes shkencor, studimor dhe çlodhës

## **Pasuritë natyrore**

Rrethi i Kukësit është një ndër rrethet e pasura me minerale të dobishme. Minerali i bakrit. Më 1962, në Gjegjan, është ngritur miniera e bakrit.

Bakri gjendet në formacionet magmatike, ka një përmbajtje të madhe metali. Shtresa mineralmbajtëse të bakrit fillojnë në sipërfaqe dhe shkojnë deri në thellësi të tokës. Minerali i bakrit përmban kryesisht kalkopirit, kalkozinë, kovelinë, bornit, malahit dhe azurite. Minerali i kromit: Rezervat nëntokësore të kromit llogariten në 15 milion ton nga të cilat 1 milion janë me cilësi të mirë me mbi 36-40%CL 203. Disa nga minierat e kromit në nivel qarku janë: miniera e Kamit ndodhet në rrethin e Tropojës, minierat e Kalimashit që gjenden në rrethin e Kukësit, miniera Vlahen dhe e Qafë Perollit të cilat ndodhen në rrethin e Hasit.

Minerali i hekur-nikeli: Vendburimet e hekur nikelit ndodhen në koren e prishjes së shkëmbinjve ultrabazik. Ato janë të përhapur në Vlahën, Vranisht, Trull-Surroj-Mamëz. Minerale jometalore: Janë të njohur rreth 11 lloje minerale jometalore dhe shkëmbinj industrialë, disa prej tyre janë: asbesti (Fshati Gegaj në rrethin e Tropojës), olivinitet (Lugu i Zi Qafë Luzhë, Kepenek, Zogaj etj), argjilat (Tropoje-Shumicë dhe Babinë-Sopot) qymyret, kuarci (Fshati Kërrnajë nga i cili ka marrë edhe emrin), gurët gëlqerorë qyteza e Fierzës), mermerët (Fshati Shumicë në Bajram Curr), rëra (formohet në lumenj si: Drini, Valbona, lumi i Tropojës, i Krumës etj) dhe zhavorri (Koj-Margegaj-Koçanaj-Shoshan dhe Begaj), gurët natyralë të ndërtimit (në Topojë dhe Has) dhe veshjes dekorative.

## **4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.**

### **4.1. Lloji i ndikimeve të identifikuar (direkte dhe jo direkte)**

Ky vlerësim kryhet në baze të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” dhe kërkesave të VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe ka si synim identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e ndotjes së mjedisit, me qëllim mbrojtjen e mjedisit.

Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

### **4.1.1. Ndikime të rëndësishme gjatë ndërtimit të aktivitetit**

#### **4.1.1.1. Referuar shkarkimeve në ujë, ajër, zhurmë dhe vibrime, në tokë, biodiversitet**

Aktiviteti i thertores ka vite që është ndërtuar, aktualisht është në fazë funksionimi.

## **4.1.2. Ndikime te rendesishme gjate funksionimit**

### **4.1.2.1. Ndikimet në biodiversitet**

Kjo zone nuk eshte e njohur per shumllojshmeri te specieve te gjalla. Fauna dhe flora ne kete zone eshte tipike e zonave malore. Aktiviteti do te zhvillohet ne siperfaqe kodrinore.

Shkarkimi ne mjediset ujore pritesa i ujerave te perdorura dhe te kontaminuara nga aktiviteti pa u trajtuar me pare, do te shkaktonin probleme serioze ne floren dhe faunen ujore te prroit e me pas te liqenit te Fierzes.

Prania e mbetjeve organike, si gjaku, dhjamrat dhe ndotja mikrobiale e ujit, mund te terhiqnin vemendjen e disa specieve ujore te cilat ushqehen me keto lloj lendesh. Gjithashtu keto mbetje mund te sherbejne edhe si ushqim per shume lloje peshqish, por edhe perhapjen e semundjeve te ndryshme tek keta te fundit e si rrjedhoje e zinxhirit ushqimor, tek njerezit e gjallesat e tjera.

### **4.1.2.2. Ndikimet në ujë**

Nga funksionimi i ketij aktiviteti ndikimet ne ujera do te jene prezente. Ndikimi ne ujerat siperfaqesore do te vije si rrjedhoje e aktivitetit jetesore te kafsheve, jashteqitjeve, pastrimit te ambjenteve te stallave, pastrimit te thertores, pastrimit e perpunimit te mishit dhe pjeseve te tjera organike, ambjentet higjeno-sanitare, etj.

Nese keto ujera do te shkarkoheshin ne mjedisin e zones pa kryer trajtimin e plote te tyre, nepermjet nje impianti, do te ishin nje kercenim serioz per zonen. Duke marre ne konsiderate ndotjen biologjike te tyre, do te rrezikonim floren dhe faunen ujore.

Persa i perket ujerave nentokesore, ambjentet jane te shtruara dhe me kanalizime, prandaj dhe nuk do te kete ndikime negative.

### **4.1.2.2. Ndikimet në tokë**

Nga zhvillimi i ketij aktiviteti ndikimet mbi toke do te jene te vogla, dhe shkarkimet do te menaxhohen ne brendesi te sipërfaqes e cila eshte ne pronësi te Z. Arjan Hallaci. Nuk do te kete ndryshim te relievit te tokes, te shtreses bimore, te perberjes gjeologjike ose te struktures se saj.

Perdorimi i tokes konsiston ne zenien e saj ndonese ne siperfaqe te vogla per ndertimin e objekteve (Thertorja & Stalla) dhe depozitimin e perkohshem te plehut organik dhe shesheve te parkimit e terminalit te ngarkim-shkarkimit te kafsheve ose produktit.

### **4.1.2.4. Ndikimet në ajër**

Ndikime ne ajer vleresohet te kete ne kete aktivitet. Ndikime do te jene nga ererat e pakendshme te jashteqitjeve te kafsheve, ndonese ato mund te perdoren si pleherues ne bujqesi.

Zhurmat do te jene ne nivele normale ne nje aktivitet te tille. Nuk do te jene te ndjeshme ne qendrat e banuara te zones.

#### **4.1.2.5. Ndikimet ne mjedisin social-ekonomik**

Ndikimi ne mjedisin social-kulturor e ekonomik nga faza e funksionimit te aktivitetit, vleresohet te jete pozitive. Kjo per shkak te nivelit te ulet ekonomik te zones dhe rritjes se punesimit ne menyre direkte te punesimit, por me teper ne menyre indirekte nga nxitja e mbareshtimit te blegtorise ne rang kombetar. Gjithashtu si nevoje e ushqimit per kafshe do te nxitet edhe bujqesia per prodhimin e drithrave e te barit e kallamishteve te ndryshme. Investim i tille, ndikon ne zhvillimin ekonomik e social-kulturor te zones e mbare vendit. Blegtoria eshte pjese e tradites dhe e menyres se mbijeteses se shume familjeve ne zonat rurale e urbane.

#### **4.1.2.6. Ndikimet qe shkaktojne ndryshimet klimatike**

Aktiviteti ne vleresim nuk do te perfshije substanca te tilla qe mund te ndikojne ne rritjen e perqendrimit te lendeve ozon-holluese ne atmosfere. Vleresohet vetem lenda djegese e mjeteve te transportit. Ne nivele te uleta.

#### **4.1.2.7. Ndikimet nderkufitare**

Projekti ne vleresim ndodhet fare prane kufirit shtetor midis shtetit Shqiptar me atij Kosovar, rreth 13 Km ne verilindje te kufirit. Ky projekt nuk ben pjese ne projektet me ndikim nderkufitar ne lidhje me shfrytëzimin e ujrave ndërkombëtare” dhe projekte te “Sigurisë së Digave”. Ndikimi mjedisor nuk vleresohet te shkaktojte efekte ne territorin e shtetit fqinj.

#### **4.1.2.8. Menaxhimi i mbetjeve te ngurta**

Mbetjet e ngurta qe vleresohet te gjenerohen do te jene kryesisht ato organike te kafsheve te therura (permbajtja e plencit dhe zorreve), te cilat do te jene ne sasi prej 300 kg/dite, por kjo mbetje me kalimin e ditëve thahet dhe ka peshe me te ulet. Kjo sasi mbetje eshte vetem ne rastet kur theret deri ne 30 krer gjedh/dite. gje e cila nuk ndodh cdo dite. Ky ka qen apaciteti maksimal qe subjekti ka arritur te there brenda nje dite. Mbetjet e kafsheve jane perdorur per shekuj si nje fertilizues dhe si ndertues dheu, pasi permbajne ushqyes dhe lende organike. Mbetja e gjeneruar nga zbrazja e plencit dhe zorreve, tërhiqet e gjitha nga banoret e zonës, te cilët e përdorin per plehërimin biologjik te tokave bujqesore.

Mbetjet e tjera te gjeneruara nga proceset e therjes te tilla si ato me kodet:

- 02 02 01 – llumra qe vijnë nga larja dhe pastrimi
- 02 02 02 – mbetjet qe vijnë nga indet shtazore
- 02 02 03 – materiale te papershatashme per konsum apo perpunim
- 02 02 04 – llumra qe vijnë nga trajtimi ne vend i rrjedhjeve
- 02 02 99 – mbetje te tjera te paspecifikuara

Fillimisht mbetjet e cituara me sipër menaxhohen nëpërmjet nje grope dekantuese qe eshte e ndërtuar me permsat 3.5 m - 4 m, ujrata e ndotura nga aktiviteti i thertores pas dekantimit bashkohen me rrjetin e kanalizimeve. Llumrat e precipituara tërhiqen nga subjekte te licensuara ne menyre periodike. Dhe trajtohen konform ligjit aktual per menaxhimin e integruar te mbetjeve.

Mbetjet e kafsheve jane perdorur per shekuj si nje fertilizues dhe si ndertues dheu , pasi permbajne ushqyes dhe lende organike. Mbetja e gjeneruar nga zbrazja e plencit dhe zorreve, tërhiqet e gjitha nga banoret e zonës, te cilët e përdorin per plehërimin biologjik te tokave bujqesore.

Mbetje e plehut organik asnjëherë nuk arrin te grumbullohet ne sasi te madhe pasi qe per te ka kerkese te larte nga banoret e zonës.

Cdo mbetje e gjeneruara nga aktiviteti Thertore dhe Stalle riperdoret.

Lekura e kafshës, lahet, kripet, me pas thahet, dhe me pas shitet tek personat e interesuar.

Këmbët pasi pastrohen, thahen dhe me pas shiten.

Mbetjet e tjera (brire, thundra) tehiqen nga gjuetarët dhe persona te interesuar.

Vetem mbetjet urbane te gjeneruara nga stafi depozitohen ne kontenieret e mbetjeve urbane.

## **5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.**

Informacion për shkarkimet në mjedis. Ndikime të rëndësishme gjatë funksionimit të aktivitetit të thertores dhe stallës së rritjes së gjedhit në funksion të saj

Shkarkimet në mjedis gjatë funksionimit të Linjes së perpunimit të mishit (Thertore) do të jenë kryesisht mbetjet e ngurta të aktivitetit, mbetje të ushqimit të bagetive, mbetjet organike të fekaleve të kafsheve, mbetjet e kafsheve të ngordhura nga shkaqe të ndryshme virale, demtime fizike, natyrore, etj, mbetjet e ujit të përdorur për ushqimin, për pastrimin, për ambientet higjieno-sanitare dhe aktiviteti jetësor i kafsheve (Urina), e cila mund të jetë e perzier me mbetjet e fekaleve ose e vecante sipas sistemit të kullimit të kapanonit. (Permbajtja e këtyre mbetjeve, vlerësohet e pasur me elemente të ndryshme, të cilët mund të jenë edhe potencial ndotje të mjedisit, përveç këtyre mbetjeve, aroma e pa këndshme dhe gazet që lirohet në ajër nga aktiviteti i stalles, vlerësohet nga ndikimet me domethënëse në fushën e cilësive mjedisore.

### **5.1. Cilësia e ajrit dhe ujërave sipërfaqësore në zonën e zbatimit të projektit**

Për zonën e Koder Lume nuk ka të dhëna të monitorimit të cilësive të mjedisit. Nuk janë kryer matje të elementeve të mjedisit të zonës nga Ministria e Mjedisit, pasi kjo zonë nuk vlerësohet si zonë problematike.

### **5.2. Pikat ku do të kryhen shkarkimet në ajër dhe ku do të shkarkohen ujërat e ndotura**

Keto shkarkime do të ndodhin në mjedisin e zonës të Linjes së perpunimit të mishit (Thertore) dhe nga pastrimi i stalles. Përse i perkete ujërave të ndotur, sipas deklarimeve të investitorit, ka instaluar një gropë dekantuese me përmasat 3.5 m x 4 m për trajtimin paraprak të tyre, para se ato të bashkohen me rrjetin e kanalizimeve.

### **5.3. Rreziqet/aksidentet e mundshme në mjedis të veprimtarisë**

Nga funksionimi i këtij aktiviteti, duke u bazuar në procesin teknologjik të deklaruar nga investitori nuk përdoren lëndë të rrezikshme për mjedisin. Kujdes i vecantë duhet të kushtohet ushqimit në trajtë të lengshme, i cili nëse shpërndahet në mjedisin e zonës, shkakton ndotje serioze.

## **6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.**

Probleme kryesore mjedisore qe potencialisht mund te lindin gjate fazes se funksionimit do te jene:

### **Rrethimi i objektit**

Objekti qe eshte ndertuar ne nje zone rurale larg qendrave te banuara te fshatit Koder-Lume, Bashkia Kukes, ky rrethim do te jete i perhershem.

### **Prodhimi i pluhurave**

Prodhimi i pluhurave ndonse ne sasi te paperfillshme do jete i perhershëm, nga lëvizja/qarkullimi i mjeteve.

### **Krijimi i zhurmave**

Gjate punes ne **Linjen e perpunimit te mishit (Thertore)**, do te rezultojne zhurma, ndotje akustike, si rezultat i perdorimit te makinave te linjes, te transportit, edhe pse ne nivele te ulëta keto zhurma do vazhdojne ne menyre te perhershme dhe do te monitorohen nje here ne 6 muaj.

### **Nevojat per shkarkimet e lengeta**

Subjekti per funksionimin normal te aktivitetit si ujrat e gjeneruara nga thertorja dhe stalla pas procesit te dekantimit edhe ato te gjeneruara nga punonjësit, janë te lidhura me rrjetin e kanalizimeve te zonës.

### **Krijimi i rrugeve te brendeshme e te jashteme**

Gjate funksionimit te **Linjen e perpunimit te mishit (Thertore) dhe stalles ne funksion te thertores**, do te rezultojne kerkesa per rruge te perhershme, mirmbajtja e tyre do te jete i vazhdueshem por eshte ndikim pozitiv .

### **Largimi i mbeturinave urbane**

Gjate funksionimit te **Linjen e perpunimit te mishit (Thertore) dhe stalles ne funksion te thertores**, do te rezultojne kerkesa per largimin e mbeturinave qe do te kryhen ne kohe dhe ne vendin e caktuar, me miratimin nga **Bashkia Kukes**, pra do te jene konform kerkesave te dhena nga kjo Bashki si dhe per pjesen tjeter te banimit.

### **Krijimi i hapësirave te gjelbera**

Gjate funksionimit te **Linjen e perpunimit te mishit (Thertore) dhe stalles ne funksion te thertores**, do te rezultojne kerkesa per sistemimin e siperfaqeve te gjelbera, konform projektit. Nje nder pikat kryesore te keti objekti eshte dhe rikompozimi i siperfaqeve te gjelberta qe do te harmonizohet dhe me objektet ekzistuese. Ky ndikim eshte i vazhdueshem por eshte ndikim pozitiv.

### **Krijimi i mbeturinave te ngurta**

Mbeturinat e ngurta me natyre dhe perberje nga ndërtimi nuk ka, pasi aktiviteti eshte ne faze funksionimi. Mbetjet e ngurta urbane vijnë nga mirembajtja e ambjenteve te jashteme te aktivitetit dhe ato te gjeneruara nga punonjësit.

Ky ndikim do te jete i perhershem por i disiplinuar pasi mbetjet urbane do te vendosen ne kontejnere dhe te ndara ne kater lloje mbetjesh. Evadimi do behet cdo dite per ne piken e grumbullimit te caktuar nga Bashkia Kukes.

### **Ndikimi vizual.**

Ky eshte nje ndikim i perhershem pasi objekti ka ndikuar ne permirsimin estetik te zones. Siç dhe shikohet problemet mjedisore si ndotje e ajrit, ujrat, sistemimi i tokes, mbetjet urbane do te kene nje ndikim te pa perfillshem gjate funksionimit te **Linjen e perpunimit te mishit (Thertore) dhe stalles ne funksion te thertores.**

## **7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS**

Nga te dhenat per shtrirjen e mundeshme hapsinore te ndikimit ne mjedis Vlersimi I Ndikimit ne Mjedise rezulton se keto ndikime do te jene vetem ne hapsiren e percaktuar te objekti.

### **Ndikimi ne ujrat siperfaqesore**

Ky ndikim do te shtrihet vetem ne siperfaqen e percaktuar te sheshit te ndertimit dhe nuk do te kete shtrirje pertej kesaj siperfaqe.

### **Prodhimi I pluhrave.**

Ky ndikim do te shtrihet vetem ne siperfaqen e percaktuar te sheshit te ndertimit dhe nuk do te kete shtrirje pertej kesaj siperfaqe.

### **Zhurmat**

Do te kene ndikim vetem vetem brenda teritorit te **Linjen e perpunimit te mishit (Thertore) dhe stalles ne funksion te thertores.**

### **Ndikimi ne toke**

Nuk do te kete ndikim pertej siperfaqes qe eshte nderuar. **Linja e perpunimit te mishit (Thertore) dhe stalles ne funksion te thertores.**

### **Krijim i hapësirave të gjelbra**

Ky ndikim do te shtrihet ne nje siperfaqe brenda sheshit te **Linjes e perpunimit te mishit (Thertore) dhe stalles ne funksion te thertores.**

### **Ndikimi paranomik**

Do te shihet pertej sheshit te ndertimit **Linjes e perpunimit te mishit (Thertore) dhe stalles ne funksion te thertores** duke dhene nje pamje estetike qe duhet te vazhdoje dhe ne objektet e tjera qe do ndertohen ne te ardhmen.



## 8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.

Perdorimi i elementeve te tille si:

- Sistemimet e jashteme
- Gjelberimi, jo vetem ne kuoten e rruges, por edhe si mbulese e gjelberuar
- Reabilitimi i rrjeteve ekzistues
- Forma e veçante artitektonike e objektit,
- Leximi ne nje konteks me te gjere urban
- E tjere:

Jane nje sere faktoresh qe do te prodhoin nje ndikim te forte nga pikepamja e permiresimit mjedisore – urbane

Ambjenti ne te cilen do te operohet ne te gjithë hapsiren per rreth por gjithnje brenda siperfaqes se **Linjes e perpunimit te mishit (Thertore) dhe Stalles ne funksion te thertores** do te permiresohet pra do reabilitohet.

- Per nderhyrjet e nevojshme ne rrjet me qellim dhe permiresimin e tij, aty ku eshte e nevojshme, do te bashkepunohet me institucionet perkatese.
- Do te permiresohet rrjeti i ujrave te zeza dhe te bardha. Ne territorin e sheshit te ndertimit nuk do kete probleme.
- Do permiresohet rrjeti i shperndarjes se ujit te pishem.
- Ndertimi i siperfaqeve te gjelbera ne hapesiren perreth objektit, eshte nje tjetër faktor per mbrojtjen e mjedisit
- Permiresimi i rrjetit rrugore te bredshem te objekti.



Sistemime te sipërfaqeve te jashtme te aktivitetit, me qellim minimizimin e impaktit viziv te tij



## **9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.**

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe duhet te zbatohen nga investitori ose nenkontratuesit per zbatimin e projektit. Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte:

### **Masat për emetimet në ajër**

Gjatë fazes së operimit burimet nga të cilat shkaktohen dhe emetohen gaze dhe grimca të ngurta janë : lëvizja e automjeteve . Lënda djegëse e cila do të përdoret nga mjetet dhe automjetet që do të operojnë do të jenë të një cilësie të mirë .

1. Mjetet dhe automjetet që do të përdoren gjatë fazes së operimit duhet ti nënshtrohen kontrollit teknik ne servise.
2. Mjetet dhe automjetet që do të përdoren nuk do të jenë të amortizuara të cilat mund të shkaktojnë emetimet e gazeve në nivele të larta në atmosferë.
3. Të realizohet spërkatja e ambjenteve në mënyrë që të reduktohet sasia e pluhurit që mund mund të shkaktohet gjatë lëvizjes së automjeteve.
4. Automjetet përreth objektit të spërkatën me ujë për të shmangur pluhurin.

### **Masat lidhur me zhurmat:**

Certifikimi i gjendjes teknike të mjeteve nga DPSHTRR;

Zbatimi i rregullimeve gjatë orëve të punës;

Kontrolli teknik i vazhdueshem i gjendjes teknike te automjeteve te punes per te shmangur zhurmat nga avarit mekanike;

Fikja e automjeteve te punes ne rastet kur nuk eshte i nevojshem perdorimi i tyre;

Planifikim i saktë i kohëzgjatjes së punimeve në terren për të mënjanuar tejzgjatjen e panevojshme të tyre;

### **Masat lidhur me cilësinë e ujrave:**

Operimi i këtij lloj aktiviteti gjeneron ujëra teknologjik dhe për këtë arsye ne rast se nuk merren masa per trajtimin e tij para se ato te shkarkohen ne ujrave pritës, apo edhe ne rrjetin e kanalizimeve ato ndikojne në mënyrë të drejtë për drejtë në ujërat sipërfaqësore ,

1. Kompania gjatë fazes së operimit të shkarkojë ujërat urbanë në një gropë septike/rrjet kanalizimesh.
2. Të sistemojë ujërat sipërfaqësorë të shëshit në të cilin operonë .
3. Të mos derdh asnjë lloj mbetje në trupat ujore qe kalojne afer objektit .

### **Masat lidhur me cilësinë e tokës:**

Në baze të analizës së vlersimit të paraqitur më lart , ndikimet në cilësinë e tokës do të hasen vetëm në rast se do të ketë shkarkime aksidentale të derdhjes se lengjeve perzier me gjakut gjate therjes se

kafsheve, te ujrave te shkarkimit te Linjes perpunimit mishit (Thertore),dhe stalles ne funksion te thertores te hidrokarbureve te cilat ndikojne ne ndotjen e asaj sipërfaqe . Madhësia e këtij ndikimi do të jetë në varësi të madhësisë së aksidentit. Kompania duhet të aplikojë masa për parandalimin e çdo aksidenti në mjedis.

1. Kompania të përcaktojë një vend të caktuar dhe të pajisur me kosha grumbullimi
2. Çdo lëndë ndihmëse do të magazinohet në kushte optimale në mënyrë që të mos ndodhë asnjë lloj shkarkimi aksidental në tokë.
3. Gjatë perimetrisë së sipërfaqes ku do të operojë kompania të hapen kanale kulluese në mënyrë që të sistemohen ujërat sipërfaqësorë të sheshit dhe të kontrollohet çdo lloj derdhje brenda sipërfaqes së projektit .

#### **Masat lidhur me cilësinë e biodiversitetin:**

Sic u analizua në kapitullin e përshkrimit të gjendjes mjedisore , ndikimet në biodiversitet nga zhvillimi i projektit janë në nivele mjaft të moderuara. Me qëllim që ndikimet që mund të shkaktohen nga projekti të qëndrojnë në këto nivele dhe ezaurimin e mundësive për reduktimin e tyre, kompania të zbatojë masat si më poshtë:

1. Rrugët dytësorë dhe e gjithë infrastruktura që do të përdorë subjekti për zbatimin e këtij projekti të spërkatën më në mënyrë periodike për të ulur nivelin e përhapjes së grimcave të ngurta në atmosferë .
2. Ndriçimi i zonës ku do të zhvillohet projekti gjatë natës të projektohet në atë mënyrë që të mos jetë shqetësuese për kafshët e egra .

#### **Masat zbutëse për reduktimin e ndikimeve në peisazh:**

Për zbutjen e ndikimeve nga prania e aktivitetit në peisazhin natyrorë kompania do të zbatojë këto masa gjatë fazes së operimit:

1. Përreth sheshit të mbillen pemë të larta
2. Mjedisit të mbahet i sistemuar dhe i pastër
3. Të shmang shkaktimin dhe përhapjen e pluhurit në atmosferë
4. Të shmangët grumbullimi i mbetjeve për një kohë të gjatë .

#### **Masat lidhur me menaxhimin e mbetjeve:**

Të menaxhohen mirë grumbullimi dhe levizja e mbetjeve urbane, duke vendosur kontenier te mbetjeve urbane brenda zones;

Të përcaktohet mënyra e transportit dhe depozitimit duke lidhur kontrata me subjekte te licensuara per menaxhimin e tyre;

Shmangja e perhapjes kaotike te mbetjeve inerte, duke percaktuar nje zone te pershtatshme per depozitimin e perkoheshem te tyre ne rast nevojje;

## **10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).**

Ky aktivitet nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton dëmtim të mjedisit nderkufitar. Aktiviteti nuk ndikon në cenimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit as të shteteve fqinje, as të qendrave të banuara të rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilësia e ajrit në kontekstin nderkufitar. Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtet fqinje.



# LICENCË

LN-9517-04-2015	NUIS/NIPT: K91423504D
Subjekti: J&F ARCHITECTURAL DESIGNER	
Adresa: Durres, DURRES, Durres, DURRES, Lagjja nr. 3, Sheshi "Iliria", E G T TOWER, kati dytë	
Kodi: III.2.A	Kod tjetër:
Data e lëshimit: 29/04/2015	Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis: Vlerësim ndikimi në mjedis dhe auditim mjedisor

Kufizime specifike

*Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi*

Detyrime specifike

*Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi*

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

Specialiteti

Nënshkrimi i sportelit:

*STREJTA GJOKA*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 11613 Prot.

Tiranë, më 10.12 2014

Nr. identifikues 216

## ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":


**ZNJ. NEVJANA ISUFI**

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

  
Lefter KOKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 5203 Prot.

Tiranë, më 23.06 2017

Nr. identifikues 477

## ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. BASHKIM SALILLARI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

  
Lefter KOKA





# LICENCË



LN-9517-04-2015	NUIS/NIPT: K91423504D
Subjekti: J&F ARCHITECTURAL DESIGNER	
Adresa: Durres, DURRES, Durres, DURRES, Lagjja nr. 3, Sheshi "Iliria", E G T TOWER, kati dytë	
Kodi: III.2.A	Kod tjetër:
Data e lëshimit: 29/04/2015	Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis: Vlerësim ndikimi në mjedis dhe auditim mjedisor

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

Specialiteti

Nënshkrimi i sportelit:

STRELA TA GJOKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 11613 Prot.

Tiranë, më 10.12 2014

Nr. identifikues 216

## ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

**ZNJ. NEVJANA ISUFI**


Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

  
Lefter KOKA







REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 5203 Prot.

Tiranë, më 23.06 2017

Nr. identifikues 477

## ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. BASHKIM SALILLARI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

  
Lefter KOKA

